

**Formular për SYLLABUS të Lëndës: Siguria Kolektive
Ndërkombëtare dhe NATO**

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Siguria Kolektive Ndërkombëtare dhe NATO
Niveli:	BA
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	III –të, Sems 5
Numri i orëve në javë:	2L+2U
Vlera në kredi – ECTS:	5 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Besfort Rrecaj
Detajet kontaktuese:	besfort.rrecaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Objektivi i kësaj lënde është që të njoftojë studentët me konceptin bazë të sigurisë individuale dhe kolektive të shteteve në një sistem ndërkombëtar pa ndonjë autoritet qëndror vendimmarrës. Në fund të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të identifikojnë parimet, dokumentet dhe dispozitat kryesore ndërkombëtare të përcaktuara nga shtetet për arritjen e sigurisë ndërkombëtare në nivle global apo regjionale. Gjatë studimit të kësaj lënde, studentët do të fokusohen veçanërisht në rolin e NATO's në ruajtjen e sigurisë së vendeve anëtare të saj por edhe në sigurinë dhe paqen ndërkombëtare në përgjithësi. Kosova bënë pjesë në sferën e interesave gjeopolike të NATO-s duke qenë pjesë e kontinentit evropian dhe së këndejmi ngërthen rolin e saj në sigurinë e përgjithshme evropiane. Ndër objektivat kryesore të politikës së jashtme të Kosovës është anëtarësimi në NATO në një të ardhme të afërt për cka edhe rrjedh rëndësia e mësimit të kësaj lënde.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i kësaj lënde mësimore është që të ofrojë njohuri për studentët e vitit të tretë të studimeve në ciklin bachelor në fakultetin juridik në lidhje me nocionin e sigurisë ndërkombëtare dhe cilat janë parimet bazë të cilat e rregullojnë sigurinë ndërkombëtare. Në mungesë të një autoritetit qëndror vendimmarrës në marrëdhëniet ndërkombëtare ku shteti është</p>

	<p>subjekt primar dhe në të njejtën kohë suprem dhe i barabartë karshi shteteve tjera, organizmi i sigurisë individuale dhe kolektive ka qenë një nga sfidat që e kanë përcjellur njerezimin gjatë historisë së tij veçanërisht pas Paqes së Vestfalisë dhe themelimit të shteteve moderne të cilat i njohim ne sot.</p> <p>Rendi i OKB-së i përcaktuar me Kartën e OKB-së përcakton parimet kryesore përmes të cilave synohet të ruhet paqja dhe siguria ndërkombëtare të përcaktuara me nenin 2 dhe Kapitullujt VI VII dhe VIII që përmbajnë dispozitat bazë të cilat lejojnë marrjen e masave individuale, rajonale në formë të ndihmës shtetërore apo organizatave rajonale si dhe në nivele të OKB-së përkatësisht KS-së.</p> <p>NATO është organizatë për siguri/mbrojtje kolektive e cila është themeluar në vitin 1949 me qëllim të mbrojtjes së sferës shteteve demokratike/kapitaliste karshi bllokut lindor nën dominimin e sistemit socialist/komunist. Studentët të fokusohen në studimin e kësaj organizate, arsytet e paraqitjes së saj, traktati për themelimin e kësaj organizate dhe organet kryesore të saj. Në veçanti studentët do të njoftohen me rishikimin e misionit të saj pas Luftës së Ftohtë dhe cili është fokusi/kërcënimi kryesor ndaj kësaj organizate pas vitit 1991. Në kuadër të kësaj lënde studentët do të njoftohen konkretisht me rolin e NATO's në Kosovës, Afganistan dhe vendet tjera.</p>		
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde studentet duhet të jetë në gjendje të:</p> <p>Kuptojnë rolin dhe organizimin e sigurisë ndërkombëtare kolektive. Cka është koncepti i sigurisë dhe mbrojtjes kolektive.</p> <p>Kuptojnë rolin e organizatave globale si OKB dhe rajonale si NATO në sigurinë kolektive si dhe roli i shteteve në organizimin e sigurisë kolektive ndërkombëtare</p> <p>Të dallojnë masat parandaluese, paqeruajtëse dhe masat për implementimin e paqes.</p>		
<p>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)</p>			
<p>Aktiviteti</p>	<p>Orë</p>	<p>Ditë/javë</p>	<p>Gjithësej</p>
<p>Ligjërata</p>	<p>2</p>	<p>15/javë</p>	<p>30</p>
<p>Ushtrime teorike/laboratorike</p>	<p>2</p>	<p>15/javë</p>	<p>30</p>

Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	2	4
Ushtrime në teren	5	1	5
Kollokfiime,seminare	4	4	16
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	3	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet ,etj	2	2	4
Totali	27		148

Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjerate interaktive e kombinuar me stil te punës praktike te bazuar në studimet e rasteve, tekste origjinale ligjore dhe politike, elemente te seminarit, folës të ftuar, dhe dokumente kërkimore praktike, provimet afatmesme dhe përfundimtare.
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i studentëve do të bëhen në mënyrë të vazhdueshme duke përfshirë këtu vijueshmërinë e rregullt të studentit në klasë, pjesëmarrjen aktive, provimi mes-semesteral dhe ai përfundimtar. Vlerësimi final i studentit do të bazohet në bazë të këtyre parametrave.</p> <p>Për arsye të qartësimit, pjesëmarrja e studentit në klasë nënkupton praninë fizike të studentit por edhe angazhimit të tij në diskutime dhe aktivitete tjera në kalsë.</p> <p>Pjesëmarrja aktive nënkupton aktivitetet shitesë të cilat i bën studentin në formë të punës individuale apo grupore gjatë semestrit. Kjo nënkupton përgatitjen e prezenteve apo seminareve mbi temat të cilat diskutohen. Studentët e këtij grupi do të vlerësohen jashtë vlerësimit mbi vlerësimin final që nënkupton se studentët e kësaj kategorie do të vlerësohen me poena shitesë varësisht nga angazhimi i tyre konkret.</p>

	<p>Më poshtë është paraqitja kuantitative në bazë të së cilave bëhet vlerësimi final i studentit:</p> <p>Provimi mes-semestral: 40%</p> <p>Provimi përfundimtar: 50 %</p> <p>Pjesëmarrja në klasë: 10%</p> <p>Pjesëmarrja aktive (prezentimet, seminarët, puna në grupe): 10 % (shitesë)</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<p>Lidija Cehulic-Vukadinovic, Euroatlantizmi (Zagreb, 2003 versioni shqip përkthyer 2006)</p> <p>Doracak i NATO's (Zyra për Informim e Traktatit Veriatlantik, 2001), http://juristat.files.ëordpress.com/2012/08/doracak-i-natos.pdf</p> <p>Zejnullah Gruda, E Drejta Ndërkombëtare Publike (Universiteti i Prishtinës, 2013)</p>
Literatura shitesë:	<p>NATO in focus: An introduction to the transatlantic alliance, publikuar në internet në faqen: http://www.nato.int/nato_static/assets/pdf/pdf_publications/1303-nato_in_focus-en.pdf</p> <p>Strategic Concept for the Defence and Security of the Members of the North Atlantic Treaty Organization 2010, publikuar në internet në faqen: http://www.nato.int/nato_static/assets/pdf/pdf_publications/2012_0214_strategic-concept-2010-eng.pdf</p> <p>Ademola Abass, Regional Organisations and the Development of Collective Security: Beyond Chapter VIII of the UN Charter (Hart Publishing, 2004)</p> <p>Lise Morje Howard, UN Peacekeeping in Civil Wars (Cambridge University Press, 2009)</p> <p>A. Le Roy Bennett: International Organizations: Principles and Issues (Prentice Hall, 1995)</p> <p>www.nato.org</p> <p>www.un.org</p>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet

<i>Java e parë:</i>	HYRJE DHE NJOFTIM ME LËNDËN
<i>Java e dytë:</i>	KONCEPTI TEORIK I SIGURISË NDËRKOMBËTARE Lit: Cehulic, 31-51
<i>Java e tretë:</i>	SIGURIA NDËRKOMBËTARE DERI NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE Lit: Gruda, 356-366
<i>Java e katërt:</i>	SIGURIA NDËRKOMBËTARE NË RENDIN E OKB-SË Lit: Gruda, 99-120
<i>Java e pestë:</i>	SIGURIA NË KONTINENTIN EVROPIAN DHE ROLI I NATO'S Lit: Doracaktu i NATOs, 29-34 Gruda, 402-405
<i>Java e gjashtë:</i>	TRANSFORMIMI I NATO'S Lit: Doracaku i NATOs, 35-60 Material shtesë vendosur ne SEMS
<i>Java e shtatë:</i>	ZGJERIMI I NATO'S Lit: Doracaku, 61-98 Material shtesë vendosru ne SEMS
<i>Java e tetë:</i>	PROVIMI MES-SEMESTRAL
<i>Java e nëntë:</i>	SIGURIA EVROPANE DHE IDENTITETI I MBROJTJES Lit: Doracaku i NATOs, 99-108 & 144-152

<i>Java e dhjetë:</i>	<p>ANGAZHIMI I NATOS'S NË MISIONET PAQERUAJTËSE</p> <p>Lit: Doracakut i NATOs, 109-142 NATO nga vështrimi i përgjithshëm, 22-25</p>
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<p>ROLI I NATO'S NË KOSOVË</p> <p>Material shtesë vendosru ne SEMS</p>
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<p>KONTROLLI I ARMATIMIT DHE ROLI I NATO'S</p> <p>Lit: Doracakut i NATOs, 144-152</p>
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<p>ORGANET KRYESORE TË NATO'S</p> <p>NATO nga vështrimi i përgjithshëm, 14-21 Material shtesë vendosru ne SEMS</p>
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	<p>SFIDAT JO-KONVENCIONALE TW SIGURISË NDËRKOMBËTARE</p> <ul style="list-style-type: none"> • Terrorizmi • Lufta hibride • Krimet kibernetike <p>Material shtesë vendosru ne SEMS</p>
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<p>PROVIMI PËRFUNDIMTAR</p>

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p><i>Mësimi dhe procesi i nxënjes se studneteve si dhe realizimii i objektivave të lendes do percillet nga profesori I lendes permes vlerësimit vazdhueshem të progresit të studentëve në një kohë dhe në një mënyrë që siguron informacion të mjaftueshem ;</i></p> <p><i>Studentët janë të inkurajuar fuqimisht për të bërë pyetje, komente dhe të marrin pjesë active në diskutime ne klasë;</i></p> <p><i>Sjellja e duhur akademike si dhe vijimi I rregullt im mesimit është një domosdoshmëri;</i></p>

Kopjimi I punës se të tjerëve, përdorimi I materialeve të pamiratuara gjatë provimeve , ose duke marrë kredi për punën që ju nuk bëni aktualisht është konsideruar mashtrim dhe nuk do të tolerohet;

- përdorimi i Lap-top lejohet vetëm kur miratohen nga profesori .

- përdorimi i telefonit celularë është I ndaluar;

Te gjitha rregullat e parapara ne Kodin Akademik te Universiteti do te jen te aplikuara ne kete lende .